



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.07.2024

Nr: 94

Ora: 16:02

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQATA PER KULTURE DEMOKRATIKE, PËR AKREDITIMIN E VËZHguesve PËR VËZHgIMIN E ZGJEDHJEVE TË PJESHME PËR Kryetar TË BASHKISË HIMARË TË DATËS 4 GUSHT 2024

Sot në datën 18.07.2024, unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova kërkesën e:

KËRKUES: Shoqata Per Kulture Demokratike, me adresë në Rruga "Ymer Kurti", Pallati 1, Shkalla 2, Tirane;

OBJEKTI: Kërkohet akreditimi si vëzhgues për vëzhgimin e zgjedhjeve te pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024.

BAZA LIGJORE: Nenet 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Vendimi nr. 19, datë 27.01.2023, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave".

Data: 18.07.2024
Ora: 16:02

Nr: 94



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

V Ë R E J:

Shoqata Per Kulture Demokratike i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën, si dhe dokumentacionin përkatës për akreditimin e 7 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Kërkesa është paraqitur në datën 18.07.2024.

Shoqata Per Kulture Demokratike, në respektim të nenit 6, pika 2 të Kodit Zgjedhor është një organizatë që gëzon të drejtën të caktojë vëzhgues në zgjedhje.

Kërkesa e paraqitur respekton afatin kohor të përcaktuar në nenin 6, pika 5, të Kodit Zgjedhor.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkesës është në përputhje me përcaktimet e nenit 6, pika 4 e vijues të Kodit Zgjedhor

PËR KËTO ARSYE:

Si dhe në mbështetje të neneve 6, 7 e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimit nr. 19, datë 27.01.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, dhe mediave”,

V E N D O S :

1. Akreditimin e 7 vëzhguesve të Shoqata Per Kulture Demokratike për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 1 (një) dite nga shpallja e tij në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 18.07.2024 Nr: 94
Ora: 16:02



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjeshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024

Aneksi I: Lista e Vëzhguesve të Miratuar të Shoqata Per Kulture Demokratike

	Emri	Mbiemri	Mandati	Seriali	Zona e vëzhgimit
1.	Rigers	Bena	Afatgjate	000016	Himarë
2.	Eglantina	Alliaj	Afatgjate	000017	Himarë
3.	Gerta	Meta	Afatgjate	000018	Himarë
4.	Gazmend	Agaj	Afatgjate	000019	Himarë
5.	Antonio	Kacani	Afatgjate	000020	Himarë
6.	Pavlo	Bena	Afatgjate	000021	Himarë
7.	Qazim	Bajraktari	Afatgjate	000022	Himarë

Data: 18.07.2024
Ora: 16:02

Nr: 94



Për miratimin e vëzhguesve, për vëzhgimin e zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë të datës 4 gusht 2024